

VENDIM
Nr. 653, datë 22.7.2015

PËR DISA NDRYSHIME E SHTESA NË VENDIMIN NR. 77, DATË 28.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KONTRIBUTET E DETYRUESHME DHE PËRFITIMET NGA SISTEMI I SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SIGURIMI I KUJDESIT SHËNDETËSOR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, "Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë", të ligjit nr. 150/2014, "Për pensionet e punonjësve të nëntokës", dhe të ligjit nr. 9136, datë 1.9.2003, "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun III, "Llojet, shuma dhe shpërndarja e kontributeve", bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 13, 14 e 16 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"13. Personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulantë, të deklarojnë dhe të paguajnë kontribut minimal mujor në shumën 4 696 (katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë, nga të cilat 3 200 (tre mijë e dyqind) lekë për sigurime shoqërore dhe 1 496 (një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë për sigurimin e kujdesit shëndetësor.

14. Për personat që punojnë si punëtorë shtëpie, punëdhënësi të deklarojë dhe të paguajë kontribut minimal mujor në shumën 3 948 (tre mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) lekë, nga të cilat 3 200 (tre mijë e dyqind) lekë për sigurime shoqërore dhe 748 (shtatëqind e dyzet e tetë) lekë për sigurimin e kujdesit shëndetësor.

...

16. Të vetëpunësuarit në bujqësi të derdhin kontribut vjetor për sigurimet shoqërore në masën 38 400 (tridhjetë e tetë mijë e katërqind) lekë, me përjashtim të të vetëpunësuarve që banojnë në rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, për të cilët masa e kontributit vjetor është 29 400 (njëzet e nëntë mijë e katërqind) lekë."

b) Shkronjat "a" dhe "c", të pikës 18, ndryshohen, si më poshtë vijon:

"a) Personat që kryejnë funksione kushtetuese, punonjësit e lartë të shtetit, sipas funksioneve, në masën 4, 3 dhe 2 % të pagës bruto, nga data 1.1.2015 e deri në datën 30.4.2015, dhe në masën 5, 4 dhe 3% të pagës bruto, nga data 1.5.2015 e në vazhdim.

...

c) Personat që kanë titullin shkencor “Profesor”, “Drejtues kërkimesh”, “Profesor i asociuar”, “Mjeshtër kërkimesh”, kur punojnë në universitetet, shkollat e larta dhe Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë, në masën e përcaktuar në nenin 4, “Masa e kontributeve”, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, nga data 1.1.2015 dhe në vazhdim.”.

Pika 21 ndryshohet, si më poshtë vijon:

c) “21. Për ish-punonjësit që kanë punuar në miniera në nëntokë dhe ish-punonjësit e industrisë ushtarake që përfitojnë trajtim financiar të veçantë, personat që u shërbejnë invalidëve paraplegjikë e tetraplegjikë dhe gratë që dalin në pension, për periudhën e kryerjes së arsimit të lartë, buxheti i shtetit derdh kontribute për degën e pensioneve në masën 21.6% të pagës minimale. Për personat që u shërbejnë invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, duke filluar nga data 1.1.2015 e në vazhdim, buxheti i shtetit derdh kontribute edhe për degën e barrëlindjeve dhe aksidenteve në punë në masën 1.7 % të pagës minimale.”.

2. Në kreun VIII, “Shuma bazë e përfitimeve”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pikat 3 dhe 5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Shuma bazë mujore e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për personat që plotësojnë kushtet për përfitim sipas dispozitave të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nga data 1.8.2015 e në vazhdim, të jetë 12 436 (dymbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë në muaj.

Përfituesit e pensionit të parakohshëm kanë të drejtën e kompensimit të çmimeve sipas masës dhe kriterëve të përcaktuara në vendimin nr. 138, datë 31.3.1994, të Këshillit të Ministrave, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”.

Përfituesit e pensionit të parakohshëm minimal kanë të drejtën edhe të kompensimit të të ardhurave, sipas masës dhe kriterëve të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave, nr. 471, datë 15.7.1996, “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”; nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”; nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”; nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”, dhe nr. 477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”, me kusht që shuma e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave të jetë 14 086 (katërmëdhjetë mijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj. Në rastet kur pensioni për vjetërsi shërbimi rezulton më i lartë se pensioni bazë dhe, bashkë me kompensimet e të ardhurave, rezulton më i lartë se shuma e të ardhurave minimale prej 14 086 (katërmëdhjetë mijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekësh, kompensimet jepen pjesore, deri në plotësimin e kësaj shume.

...

5. E ardhura për barrëlindje për gratë të cilat periudhën e sigurimit për efekt të përfitimit të barrëlindjes e kanë kanë si persona të vetëpunësuar në bujqësi ose kanë më shumë se 6 muaj të periudhës së fundit të sigurimit nga data e lindjes së të drejtës për pagesë, si persona të vetëpunësuar në bujqësi, duke filluar nga data 1.8.2015, e në vazhdim, do të jetë 8 516 (tetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë në muaj.”.

b) Pas pikës 6 shtohet pika 7, me këtë përmbajtje:

“7. Për zbatim të paragrafit të dytë të shkronjës “a”, të nenit 5, të ligjit nr. 7514, datë 30.9.1991, “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar, pensioni mesatar është sa 1,5-fishi i pensionit bazë të përcaktuar në pikën 2, të këtij

vendimi. Kur personi që përfiton nga nenin 1, i ligjit të sipërshtuar nuk plotëson periudhën e sigurimit sipas përcaktimeve në nenin 92, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, mund të zgjedhë të marrë pension të pjesshëm mesatar, shuma e të cilit përlogaritet duke shumëzuar pensionin mesatar me raportin midis periudhës faktike të sigurimit me periudhën e përcaktuar në nenin 92, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, për vitin përkatës.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.8.2015.

KRYEMINISTRI

Edi Rama